

Arsimi fetar te shqiptarët në shkollat shtetërore të Maqedonisë: nevoja dhe sfidat

Naser Ramadani¹

Abstract

The best way to enhance its conscience for a society is through proper education. Education can be achieved in different ways, however most effective and successful it can be accomplished when being done systematically for instance at schools, universities, institutes etc.

Thorough education must include all educative components such as: intellectual, spiritual, moral, civil, physic and esthetic education. Looking at state school curriculums we can easily understand that the fulfillment of all those components leaves a lot to desire. That makes the inclusion of religious education in school curriculums a necessity.

The political system of Republic of Macedonia underwent changes in 2010/2011. These changes came after countless applications made by Islamic Community addressed to the Ministry of Education. At that time, "Religious teaching" was incorporated within education curriculums at the state schools as a *free choice* for pupils. Constitution Court however reversed its decision and the following year this subject was named "Religious Ethics".

The application of religious subject inclusion at school curriculums was based on many surveys with pupils, parents and teachers. These surveys continued years after this subject first became part of school curriculums in order to see its impact and its necessity. Results were staggering in terms of importance of this subject on broader education of pupils.

Nevertheless, this subject faces challenges of different nature. Most important of all is the hurdles of incorporating this subject forward by different political and laic circles alike. Another concern is pedagogical and didactic-methodical preparations

1 Fakulteti i shkencave islame-Shkup

of teachers who will lecture this subject as well as preparation of text books according to contemporary standards adapter to psycho- physical abilities of pupils. Incorporation of religious education in state schools continues to be an important priority for all Islamic Communities and different institutions throughout Albanian community on Balkan Peninsula.

* * *

Njeriu si genie shoqërore është i krijuar në atë mënyrë që të pranojë arsimim dhe edukim. Ai lind në këtë botë dhe nuk bart me vete njohuri rreth jetës dhe hapësirës që e rrethon. Mirëpo, me vete bart të gjitha parakushtet që ia mundësojnë atij arsimimin dhe edukimin. Ai posedon shqisa me të cilat lidhet me botën e jashtme. Me kalimin e kohës, ai ndjen nevojën për zhvillimin e aftësive të tij intelektuale, morale, shpirtërore, fizike etj., respektivisht për arsimim dhe edukim. Për këtë, vërejmë se të gjitha fetë, konventat ndërkombëtare dhe ligjet e shteteve i japin prioritet arsimimit dhe edukimit të njeriut. Ato llogariten si nevojë shumë e rëndësishme për ngritjen e vetëdijes së njeriut dhe përparimit të shoqërisë.

Vetëm me anë të arsimimit dhe edukimit, njeriu mund të formohet, mund të bëhet qytetar i vlefshëm dhe i dobishëm për veten, familjen, shoqërinë dhe për mbarë njerëzimin. Ai, me anë të arsimimit dhe edukimit, vetëdijësohet që t'i kuptojë të drejtat dhe obligimet e tij në shoqëri. Për këtë, të gjitha shtetet themelojnë institucione edukative-arsimore, shkolla, universitete, akademi të ndryshme etj.

Nëse themi se "shkolla është institucion me organizim të veçantë, detyra themelore e së cilës është realizimi i qëllimeve dhe detyrave të procesit të edukimit,² tëherë nënkuptohet se edukimi dhe arsimimi kanë qëllime dhe detyra të caktuara, të cilat duhet të realizohen. Këto detyra dhe qëllime përfshihen në planin dhe programin mësimor, të cilat ngrihen mbi filozofinë e arsimimit dhe edukimit.

Çdo popull e ka filozofinë e veçantë të jetës. Në filozofinë e popujve mund të ndikojnë shumë faktorë. Aty merr pjesë feja, kultura, gjuha, historia, tradita, koha, vendi etj. Mbi bazën e filozofisë së popujve përcaktohen qëllimet dhe detyrat, të cilat përfshihen në planin dhe programin mësimor.

Të gjitha planet dhe programet mësimore, respektivisht lëndët dhe përmbajtjet e tyre kanë për qëllim zhvillimin dhe aftësimin e nxënësve rreth pesë komponentëve kryesorë: edukimit fizik, intelektual, moral, punues dhe estetik.³

Ndonëse të gjitha këto qëllime të sipërpërmendura janë shumë fisnike dhe të dobishme për nxënësit, megjithatë ato janë të mangëta, ngase mungon njëri prej komponentëve më të rëndësishëm të edukimit dhe arsimimit të nxënësve, e që është edukimi shpirtëror. Nevoja për edukim shpirtëror, respektivisht fetar, krahas nevojës për edukim në pesë komponentët e lart-cituar është shumë e madhe.

Po cila është nevoja për edukim dhe arsimim fetar? Pse duhet të inkorporohet në shkollat publike shtetërore? Cilat janë qëllimet e kësaj lënde? Ka pyetje të shumta që mund të parashtrihen në këtë drejtim dhe të cilat kërkojnë përgjigje.

2 Grup autorësh, *Pedagoški leksikon* (Beograd, 1996), f. 567.

3 Abdylaziz Veseli, *Pedagogjia parashkollore* (Prishtinë, 1999).

Fillimisht, këtë çështje duhet ta kuptojmë si të drejtë individuale të çdo personi. Çdokush ka të drejtë të edukohet në frymën e fesë të cilës ai i takon. Kjo bën pjesë në të drejtat dhe liritë e njeriut.

Edukimi dhe arsimimi fetar, këtu kam për qëllim atë islam, ngrihet mbi një filozofi të kompletuar që formon te nxënësi dhe individi botëkuptime të qarta ndaj Zotit, njeriut, jetës dhe hapësirës në të cilën jeton.

Filozofia islame paraqet një sistem të kompletuar edukativo-arsimor. Lënda fetare e cila mendojmë se duhet të jetë pjesë e plan-programit mësimor në shkollat publike, në brendinë e saj duhet të përfshijë përmbajtje mësimore të cilat përputhen me filozofinë islame ndaj Zotit, njeriut, jetës dhe hapësirës si dhe duhet të ketë qëllim final përgatitjen e individit të vlefshëm dhe të dobishëm për veten, familjen dhe mbarë shoqërinë⁴.

Po çfarë synon realizimi i kësaj lënde dhe cilat janë qëllimet dhe objektivat e saj? S'ka dyshim se islami si sistem i kompletuar ka për qëllim aftësimin e të riut që të bëhet anëtar i dobishëm dhe aktiv në bashkësinë njerëzore. Mirëpo, ky aftësim duhet të realizohet duke përfutur parafytyrime të sakta rreth Zotit, njeriut, jetës dhe hapësirës që e rrethon.

Gjatë hartimit të planeve dhe programeve mësimore është shumë e arsyeshme që të merren parasysh edhe kërkesat e popullatës, përkatësisht kërkesat e prindërve, nxënësve dhe arsimtarëve. Nëse themi se "shkolla është një sistem i krijuar nga shoqëria për interesat e vetë shoqërisë,⁵ atëherë është më se e nevojshme që të merren parasysh interesat e shoqërisë, e cila përbëhet nga prindërit, nxënësit dhe arsimtarët.

Në lidhje me nevojën e inkorporimit të mësimi fetar nëpër shkollat publike shtetërore në Republikën e Maqedonisë, ne kemi realizuar një anketim, ku në bazën metodologjike kërkimore-hulumtuuese janë përfshirë tri grupe kryesore të popullatës: nxënësit shqiptarë të klasës së tetë të shkollave fillore dhe të vitit të katërt të shkollave të mesme në Republikën e Maqedonisë, të dy gjinitë, personeli arsimor dhe prindërit.

Shënimet që na kanë shërbyer si mbështetje me rastin e formimit të kampionit i kemi marrë nga institucionet zyrtare. Kështu, të dhënat që na ofrohen nga Ministria për Arsim dhe Shkencë e Republikës së Maqedonisë na bëjnë me dije se numri i përgjithshëm i nxënësve të klasave të teta të shqiptarëve për vitin shkollor 2006-2005 është përafërsisht 9468 nxënës dhe nxënëse, ndërsa numri i nxënësve shqiptarë të shkollave të mesme është përafërsisht 4211 nxënës dhe nxënëse. Kampioni reprezentativ përfshin 600 nxënës të klasave të teta ose 6.33 %, ku 300 prej tyre janë nxënës dhe 300 nxënëse si dhe 400 nxënës të vitit të katërt të shkollave të mesme ose 9.49 % nga numri i përgjithshëm i nxënësve shqiptarë në Maqedoni, ku 200 prej tyre janë nxënës dhe 200 nxënëse.

4 Dr. Abdurrahman Salih, *Med'hal ilet Terbijetil islamijeti ve turuk tedrisiha* (Aman: Darul Furkan, 1991), f. 16.

5 Grup autorësh, *Qeverisja në arsim* (Prishtinë, 2003), f. 26.

Reprezentacioni kërkimor është zgjedhur nga Shkupi me rrethinat dhe Tetova me rrethinat. Sipas të dhënave statistikore, në Shkup dhe fshatrat përreth tij, në klasën e tetë, shkollën e vijnë afër 2700 nxënës të të dy gjinive, ndërsa mostra përbëhet prej 300 nxënësve, që do të thotë 11.11 % nga numri i përgjithshëm i nxënësve. Nga ky numër, 150 janë nga qyteti i Shkupit, ku 75 prej tyre janë nxënës dhe 75 nxënëse, ndërsa 150 të tjerë janë nga fshatrat Saraj dhe Kondovë të rrethit të Shkupit, ku 75 prej tyre janë nxënës dhe 75 nxënëse. Burimet e njëjta na bëjnë me dije se edhe në Tetovë dhe fshatrat përreth saj mësimet i vijnë afër 2700 nxënës të të dy gjinive. Të njëjtën zgjedhje e kam bërë edhe këtu, do të thotë gjysma e nxënësve janë prej qytetit, ndërsa gjysma tjetër prej fshatrave Grupçin dhe Pallaticë, si dhe gjysma e tyre nxënës dhe gjysma nxënëse.

Në vitin e katërt të shkollave të mesme, në Shkup mësimet i vijnë afër 910 nxënës të të dy gjinive, ndërsa mostra përbëhet prej 200 nxënësve, që do të thotë 21.97 % e nxënësve, ku 100 prej tyre janë nxënës dhe 100 nxënëse. Në Tetovë, në vitin e katërt mësimet i vijnë përafërsisht 1566 nxënës dhe nxënëse, ndërsa mostra përbëhet prej 200 nxënësve ose 12.77 % e nxënësve, ku 100 prej tyre janë nxënës dhe 100 nxënëse.

Në zgjedhjen e mostrës, kemi pasur kujdes për zgjedhjen proporcionale të meshkujve dhe femrave, si dhe ndarjen e tyre në vende urbane dhe rurale.

Duke u nisur nga rëndësia e mendimeve dhe e qëndrimeve të kësaj popullate, kemi planifikuar që në hulumtim të përfshijmë edhe një numër të konsiderueshëm të arsimtarëve të të njëjtave paralele dhe klasave ku janë hulumtuar nxënësit. Mostrën e personelit arsimor e përbëjnë 250 arsimtarë, prej të cilëve 150 meshkuj dhe 100 femra.

Krahas nxënësve dhe arsimtarëve, në anketimin tonë janë përfshirë edhe prindërit. Numri i tyre është 150 prindër nga prindërit e nxënësve të anketuar, ku 112 prej tyre ishin meshkuj dhe 38 femra.

Pyetësi i nxënësve, arsimtarëve dhe prindërve në lidhje me problematikën në fjalë ka përfshirë disa pyetje, prej të cilave do të veçojmë vetëm dy.

1. Çfarë mendoni për inkorporimin e mësim-besimit fetar në shkollat shtetërore?
 1. Shumë të nevojshëm;
 2. Të nevojshëm;
 3. Pak të nevojshëm;
 4. Aspak të nevojshëm.

2. Mësim-besimi fetar duhet të mësohet:
 1. vetëm në shkollën fillore.
 2. në shkollën fillore dhe atë të mesme.
 3. në të gjitha fazat e arsimit.

Rezultatet dhe analizimi i tyre

Në bazë të analizës, rezultatet e arritura ofrojnë:

Në lidhje me pyetjen e parë kemi rezultatet e paraqitura në tabelë.

Tabela 1. Përgjigjet e nxënësve të klasave të teta

	Opsionet për zgjedhje	Numri	Përqindja
1	Shumë i nevojshëm	406	67.66 %
2	I nevojshëm	139	23.16 %
3	Pak i nevojshëm	24	4 %
4	Aspak i nevojshëm	12	2 %
5	Pa përgjigje	19	3.16 %

Tabela 2. Përgjigjet e nxënësve të vitit të katërt

	Opsionet për zgjedhje	Numri	Përqindja
1	Shumë i nevojshëm	245	61.25 %
2	I nevojshëm	109	27.25 %
3	Pak i nevojshëm	21	5.5 %
4	Aspak i nevojshëm	10	2.5 %
5	Pa përgjigje	14	3.5 %

Tabela 3. Përgjigjet e arsimtarëve

	Opsionet për zgjedhje	Numri	Përqindja
1	Shumë i nevojshëm	81	32.4 %
2	I nevojshëm	98	39.2 %
3	Pak i nevojshëm	44	17.6 %
4	Aspak i nevojshëm	24	9.6 %
5	Pa përgjigje	3	1.2 %

Tabela 4. Përgjigjet e prindërve

	Opsionet për zgjedhje	Numri	Përqindja
1	Shumë i nevojshëm	87	58 %
2	I nevojshëm	44	29.33 %
3	Pak i nevojshëm	15	10 %
4	Aspak i nevojshëm	3	2 %
5	Pa përgjigje	1	0.66 %

Tabela 5. Përgjigjet e nxënësve, arsimtarëve dhe prindërve bashkërisht

	Opsionet për zgjedhje	Numri	Përqindja
1	Shumë i nevojshëm	819	58.5 %
2	I nevojshëm	390	27.8 %
3	Pak i nevojshëm	104	7.4 %
4	Aspak i nevojshëm	49	3.5 %
5	Pa përgjigje	37	2.6 %

Në lidhje me pyetjen e dytë, po ofrojmë vetëm përgjigjet e të anketuarve bashkërisht.

Nga numri i përgjithshëm i nxënësve, arsimtarëve dhe prindërve, e që ishte 1400, shihet se 162 ose 11.57 % mendojnë se duhet mësuar vetëm në shkollën fillore, 240 ose 17.14 % janë përcaktuar për shkollën fillore dhe atë të mesme, 937 ose 66.92 % për të gjitha fazat e arsimit dhe 61 ose 4.35 % pa përgjigje.

Tabela 6. Përgjigjet e nxënësve, arsimtarëve dhe prindërve bashkërisht

	Opsionet për zgjedhje	Numri	Përqindja
1	Vetëm në shkollën fillore	162	11.57 %
2	Në shkollën fillore dhe atë të mesme	240	17.14 %
3	Në gjitha fazat e arsimit	937	66.92 %
4	Pa përgjigje	61	4.35 %

Edhe krahas kërkesave të shumta nga ana e Bashkësisë Fetare Islame për inkorporimin e lëndës së mësim- besimit në sistemin edukativo-arsimor që nga rënia e sistemit komunist më 1991, mirëpo një gjë e tillë u realizua vetëm në vitin shkollor 2010-2011. Inkorporimi i kësaj lënde në sistemin arsimor shkaktoi reagime të shumta në mesin e shtresave të ndryshme. Shumë prej intelektualëve, pedagogëve, psikologëve, por edhe vetë nxënësit, arsimtarët dhe prindërit e përkrahën një vendim të tillë. Por, në anën tjetër kishte edhe një numër tjetër njerëzish që e kundërshtonin atë. Kjo lëndë në fillim ishte emërtuar “Mësim- besimi fetar”,

mirëpo më pas, me vendim të Gjyqit Kushtetues ky emërtim u ndalua dhe e njëjta lëndë, në vitin vijues u emërtua “Etika e religjioneve”.

Pas disa viteve nga inkorporimi i kësaj lënde, ishte më se e nevojshme të dihej qëndrimi i nxënësve ndaj kësaj lënde, që tanimë vetëm e kishin mësuar atë. Për të mësuar për qëndrimin e tyre, realizuam një anketim me të gjithë nxënësit e Komunës së Likovës, të cilët në vitin 2013-2014 ishin në klasën e gjashtë dhe kishin mësuar këtë lëndë. Numri i nxënësve të anketuar ishte 308, prej të cilëve 160 meshkuj dhe 148 femra.

Qëllimi i këtij hulumtimi ishte që të mësohej qëndrimi i nxënësve të klasës së gjashtë të Komunës së Likovës ndaj disa çështjeve, në mesin e të cilave edhe për vlerën e lëndës “Etika e religjioneve”, për nga dobia edukative-arsimore për nxënësit dhe në cilat klasa është e nevojshme të mësohet kjo lëndë.

Hulumtimin tonë e zhvilluam në bazë të hipotezave të mëposhtme:

Lënda “Etika e religjioneve” për nga dobia edukativo-arsimore për nxënësit është shumë e nevojshme.

Lënda “Etika e religjioneve” është e nevojshme të mësohet që nga klasa e gjashtë e deri në klasën e nëntë.

Për të mësuar qëndrimin e nxënësve në lidhje me hipotezat e lartshënuara, parashtruam mes tjerash edhe këto dy pyetje për nxënësit. Secila pyetje ishte e lidhur me njërin nga hipotezat. Pyetjet ishin si më poshtë:

1. Si e vlerësoni lëndën “Etika e religjioneve” për nga dobia edukativo-arsimore për nxënësit:
 - a. Shumë e nevojshme;
 - b. Pak e nevojshme;
 - c. Aspak e nevojshme.

2. Lënda “Etika e religjioneve” është e nevojshme të mësohet:
 - a. vetëm në klasën e gjashtë.
 - b. në klasën e gjashtë dhe të shtatë.
 - c. në klasën e gjashtë, shtatë dhe të tetë.
 - d. në klasën e gjashtë, shtatë, tetë dhe të nëntë.

Sa i përket hipotezës së parë, në të cilën thuhet selënda “Etika e religjioneve” për nga dobia edukative-arsimore për nxënësit është shumë e nevojshme, së pari duhet të shihen se cilat janë dobiet edukativo-arsimore të kësaj lënde.


Se sa kjo lëndë është e dobishme për nxënësit për nga dobia edukativo-arsimore, parashtruam këtë pyetje para nxënësve që e kishin mësuar këtë lëndë. Nga përgjigjet që morëm prej tyre rezultojnë se prej 308 nxënësve dhe nxënësve të anketuar, 305 janë të mendimit se është “shumë e nevojshme”, vetëm tre ishin të mendimit se është “pak e nevojshme”, ndërsa asnjë nxënës nuk e ndante mendimin se është “aspak e nevojshme”.

Nuk vërehen dallime mes meshkujve dhe femrave në këtë çështje. Prej 160 meshkujve të anketuar, 158 ishin përcaktuar për atë se është “shumë e nevojshme”, vetëm dy ishin të mendimit se është “pak e nevojshme”. Në anën tjetër, prej 148 nxënësve të anketuara, 147 u përcaktuan për opsionin e parë, ndërsa vetëm një për opsionin e dytë.


Tabela 7. Përgjigjet e nxënësve në lidhje me pyetjen: Si e vlerësoni lëndën “Etika e religjioneve” për nga dobia edukative-arsimore për nxënësit?

	Opsionet për zgjedhje	Nr. i përgjithshëm	Meshkujt	Femrat	Përqindja
1	Shumë e nevojshme	305	158	147	99 %
2	Pak e nevojshme	3	02	01	01 %
3	Aspak e nevojshme	0	00	00	00 %
4	Totali	308	160	148	100 %

Grafiku nr. 2. Qëndrimet e të gjithë nxënësve



Grafiku nr. 3. Qëndrimet e meshkujve dhe femrave



Sa i përket asaj se sa kohë duhet mësuar lënda “Etika e religjioneve”, çështja ka mbetur e hapur. Byroja për Zhvillim të Arsimit ka vendosur që të mësohet vetëm një vit. Në fillim ishte në klasën e pestë të mësimit tetëvjeçar, ndërsa tani është në klasën e gjashtë të mësimit nëntëvjeçar.


A duhet mësuar kjo lëndë vetëm një vit apo më shumë, këtë pyetje ua parashtruam nxënësve në anketimin e bërë. Rezultatet e nxjerra nga anketimi, flasin se 273 nxënës nga gjithsej 308, ishin të mendimit se kjo lëndë duhet mësuar që nga klasa e gjashtë deri në klasën e nëntë të arsimit fillor. 12 nxënës ishin të mendimit se duhet mësuar vetëm në klasën e gjashtë, 14 nxënës ndanin mendimin se duhet mësuar në klasën e gjashtë dhe të shtatë, ndërsa 9 nxënës mendonin se duhet mësuar në klasën e gjashtë, shtatë dhe të tetë.

Qëndrimet e meshkujve dhe të femrave në lidhje me këtë çështje ishin shumë të përafërta. Prej 160 nxënësve të anketuar, 4 mendonin se duhet mësuar vetëm në klasën e gjashtë, 10 në klasën e gjashtë dhe të shtatë, 5 në klasën e gjashtë, shtatë dhe të tetë, ndërsa 141 ishin të mendimit se duhet mësuar nga klasa e gjashtë deri në klasën e nëntë. Në anën tjetër, prej 148 nxënësve të anketuara, 8 mendonin se duhet mësuar vetëm në klasën e gjashtë, 4 në klasën e gjashtë dhe të shtatë, 4 në klasën e gjashtë, shtatë dhe të tetë, ndërsa 132 ishin të mendimit se duhet mësuar nga klasa e gjashtë deri në klasën e nëntë. Këto të dhëna në mënyrë tabelare shihen kështu:


Tabela 8. Përgjigjet e nxënësve në lidhje me pyetjen: Lënda “Etika e religjioneve” është e nevojshme të mësohet:

	Opsionet për zgjedhje	Nr. i përgjithshëm	Meshkujt	Femrat	Përqindja
1	Vetëm në klasën e gjashtë	12	04	08	3.89
2	Në klasën e gjashtë dhe të shtatë	14	10	04	4.54
3	Në klasën e gjashtë, shtatë dhe të tetë	09	05	04	2.92
4	Në klasën e gjashtë, shtatë, tetë dhe të nëntë	273	141	132	88.63
5	Totali	308	160	148	100 %

Grafiku nr. 4. Qëndrimet e të gjithë nxënësve



Grafiku nr. 5. Qëndrimet e meshkujve dhe të femrave



Nëse bëjmë një krahasim mes pyetjes së parë, ku pyetej se sa është e dobishme lënda “Etika e religjioneve” për nxënësit në aspektin edukativo-arsimor dhe asaj të dytë ku mbi 88 % e nxënësve mendojnë se duhet të mësohet që nga klasa e gjashtë deri në të nëntën, mund të konkludohet se kjo lëndë është njëra ndër lëndët më të rëndësishme që i duhet kushtuar kujdes i veçantë.

Nëse i tërë procesi mësimor organizohet për interesin e nxënësve, respektivisht për edukimin dhe arsimimin e tyre, atëherë duhet të merren parasysh kërkesat e tyre. Me siguri që ata te kjo lëndë gjejnë çështjet që u duhen atyre në përditshmëri, e në rend të parë edukimin shpirtëror.

Në bazë të rezultateve të lartshënuara mund të konkludohet se:

Duke analizuar rezultatet e nxjerra nga pyetja e parë dhe duke analizuar $X^2=0.17$ dhe $p=0.68$, konstatojmë se nuk ka dallim të rëndësishëm statistikor.

Në bazë të këtyre rezultateve, hipoteza e parë se “Lënda “Etika e religjioneve” për nga dobia edukativo-arsimore për nxënësit është shumë e nevojshme”, verifikohet.

Duke analizuar rezultatet e nxjerra nga pyetja e dytë dhe duke analizuar $X^2=2.403$ dhe $p=0.4931$ konstatojmë se nuk ka dallim të rëndësishëm statistikor.

Në bazë të këtyre rezultateve, hipoteza e dytë se “Lënda “Etika e religjioneve” është e nevojshme të mësohet që nga klasa e gjashtë e deri në klasën e nëntë”, verifikohet.

Pas gjithë kësaj, mund të thuhet se konstatimi i Ministrisë së Arsimit se lënda “Etika e religjioneve” në testin ekstern në vitin 2014, ka arritur notën 4.42 si notë më e lartë nga të gjitha lëndët, është plotësisht i kuptueshëm.

Krahas gjithë kësaj që u tha më lart rreth nevojës dhe qëndrimit të nxënësve, arsimtarëve dhe prindërve në lidhje me inkorporimin e arsimit fetar në shkollat shtetërore, vërejmë një sërë sfidash të cilat pengojnë zbatimin e saj në formën më të mirë.

Sfida më e rëndësishme është pengesa e qarqeve të ndryshme politike dhe laike. Politikanët shqiptarë në trojet e ndryshme shqiptare, akoma nuk po marrin guximin për inkorporimin e kësaj lënde në shkollat shtetërore. Andaj, duhet punuar më shumë në këtë drejtim, në veçanti me ministrinë e arsimit të vendeve të ndryshme, me qëllim që të binden se kjo lëndë është kërkesë e vetë nxënësve, prindërve dhe arsimtarëve dhe në anën tjetër jo vetëm që nuk bie në kundërshtim me plan-programet dhe qëllimet e përgjithshme edukative-arsimore, por përputhet plotësisht.

Sfidë tjetër me rëndësi është edhe përgatitja pedagogjike dhe didaktike-metodike e kuadrit edukativo-arsimor. Me siguri që zbatues të kësaj lënde duhet të jenë teologë islamw, të cilët kanë kryer fakultete islame në vend dhe jashtë. Kryerja e fakulteteve u mundëson teologëve përgatitje profesionale, gjë e cila nuk është e mjaftueshme për të qenë zbatues të kësaj lënde. Andaj, është më se e nevojshme që këtyre teologëve t’u bëhet edhe përgatitja didaktike- metodike. Me këtë nënk-

uptojmë që teologët duhet të kryejnë disa kurse ku të aftësohen për zbatimin e kësaj lënde. Mes lëndëve që duhet mësuar janë: Pedagogjia, Didaktika, Metodika e mësim- besimit dhe Psikologjia. Arsimitarëve të lëndës fetare në Maqedoni u është kushtëzuar të kryejnë studimet specialistike për metodikën e mësim- besimit, që është realizuar në kuadër të Fakultetit filozofik pranë Universitetit të Tetovës. Prej vitit 2017-2016, në Fakultetin e Shkencave Islame në Shkup është akredituar edhe programi: Metodika e mësim- besimit fetar.⁶

Sfidë tjetër është edhe përgatitja e teksteve mësimore sipas standardeve bashkëkohore që të përshtaten me aftësitë psiko-fizike të nxënësve. Me siguri që teksti mësimor si mjet didaktik i nënshtrohet disa kërkesave pedagogjike dhe didaktike-metodike gjatë hartimit të tij. Andaj duhet pasur kujdes i veçantë gjatë përgatitjes së tij, që të merren parasysh të gjitha këto kërkesa, me qëllim që të realizohet qëllimi edukativ i tyre. Duhet pasur parasysh që përmbajtja e teksteve të jetë e përshtatshme me aftësitë psiko-fizike të nxënësve. Në anën tjetër, këto tekste duhet të jenë të ilustruara me fotografi dhe materiale të tjera që përmbajtjen e bëjnë sa më të qartë. Përgatitjen e teksteve mësimore mund ta realizojnë persona të përgatitur mirë, me njohuri të mjaftueshme profesionale dhe me përgatitje didaktike-metodike.

Rezultatet dhe rekomandimet:

Bazuar në rezultatet e hulumtimeve empirike në lidhje me nevojën dhe dobinë e inkorporimit të mësim- besimit fetar, respektivisht “Etika e religjioneve” në sistemin edukativo-arsimor në Republikën e Maqedonisë, mund të konstatojmë se:

- Planet dhe programet mësimore aktuale kërkojnë rishikim;
- Nevoja për inkorporimin e mësim- besimit fetar në sistemin edukativo-arsimor gjatë disa viteve është bërë imperativ kohe dhe se mund të ndihmojë shumë në mënjanimin e anomalive të ndryshme morale;
- Shkolla si institucion edukativo-arsimor, në mënyrë sistematike, të planifikuar dhe të programuar, duhet të realizojw qëllimet dhe detyrat e edukatës, në mesin e të cilave edhe edukatën shpirtërore dhe morale, për të cilën shumë mund të kontribuojë lënda fetare;
- Nxënësit, arsimtarët dhe prindërit vërejnë mungesën e edukimit shpirtëror dhe fetar që ekziston në shkollat tona, andaj kërkojnë që një gjë e tillë të kompletohet;
- Qeveria duhet t’u bashkëngjitet të gjitha qeverive përparimtare evropiane dhe botërore dhe të zbatojë inkorporimin e mësim- besimit fetar në sistemin edukativo-arsimor;

6 Arkivi i Fakultetit të shkencave islame-Shkup. Vendimi i arkivuar me nr. 04/1 i datës 04.01.2017. Vendimi i lëshuar në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës të Republikës së Maqedonisë me nr. 17-27/2 të datës 28.12.2016.

- Lënda “Etika e religjioneve” të kalojë nga statusi i lëndës zgjedhore në lëndë obliguese;
- Lënda “Etika e religjioneve” të mësohet jo vetëm në klasën e gjashtë, por edhe në klasat e mbetura të arsimit fillor;
- Bashkësia fetare islame të marrë përsipër përgatitjen e kuadrove dhe të teksteve mësimore të duhura për realizimin e këtij qëllimi.